

Fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirja



uster

Wohnstadt am Wasser

MIRË SE VINI NË USTER INFORMACIONE PËR TË SAPOARDHURIT NGA JASHTË





Në këtë broshurë do të gjeni informacione të dobishme dhe interesante, që do t'ju mbështetin për tu ambientuar me jetesën në Zvicër. Nëse keni pyetje, për të cilat nuk gjeni përgjigje në këtë broshurë, mund t'i drejtoheni Qendrës për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen.

Qyteti Uster

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Bahnhofstrasse 17

8610 Uster

044 944 72 06

079 876 72 92 (WhatsApp)

Email

integration@uster.ch

MIRË SE VINI NË USTER

Në emër të qytetit Uster, ju urojmë përziemërsisht mirëseardhjen.

Na vjen mirë që keni zgjedhur Usterin si vendbanimin tuaj të ri.

Me mbi 35 000 banorë, Usteri është qyteti i tretë më i madh i kantonit të Zyrihut dhe renditet ndër njëzet qytetet më të mëdha të Zvicrës.

Usteri ofron sot dhe në të ardhmen një cilësi të mirë të jetesës urbane. Ky qytet ofron një sërë ekspozitash dhe koncertesh në sferën kulturore dhe qendra sportive si: pishina të brendshme me pishina olimpike 50-metërshe ose salla sportive Buchholz. Përveç kësaj, rreth 250 klube ofrojnë aktivitete të shumëllojshme.

PASQYRA E LËNDËS

Të drejtat dhe detyrat

Vlerat dhe zakonet	6
Politika	7
Taksat	8

Banimi

Informacione të përgjithshme	9
Sigurimi i shtëpisë	10
Tarifat	10
Plehrat dhe riciklimi	10

Shëndeti dhe çështjet sociale

Sëmundjet dhe urgjencat	11
Sigurimi i shëndetit dhe ulja e primeve	14
Sigurimet	15
Sigurimi shoqëror - Parimi i tre kolonave	16
Sigurimi i papunësisë (ALV)	17
Shërbime plotësuese dhe kompensimi i të ardhurave	17

Arsimi dhe puna

Çfarë duhet të dini për punën	18
Këshillimi profesional (BIZ)	19

Papunësia (RAV)	20
-----------------	----

Njohja e diplomës	20
-------------------	----

Lëvizja

Transporti publik	21
-------------------	----

Transporti rrugor	22
-------------------	----

Lëvizja me makina me qira (lëvizja e përbashkët)	23
--	----

Pikat e kontaktit dhe shërbimet në zonën e Usterit

Qyteti Uster - Pika qendrore e kontaktit	24
--	----

Mësimi i gjermanishtes	25
------------------------	----

Biblioteka e qytetit Uster	26
----------------------------	----

Qendra për familjet	27
---------------------	----

Koha e lirë

Klubet	28
--------	----

Puna vullnetare	28
-----------------	----

Eventet në qytetin Uster	28
--------------------------	----

Informacione të mëtejshme

Pikat e kontaktit	29
-------------------	----

Urgjenca

Numrat dhe adresat e urgjencës



TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Vlerat dhe zakonet

Zvicra, ky vend i vogël në mes të Evropës, ka rreth 8.5 milionë banorë (gjendja e vitit 2019). Ata banojnë në 26 kantone dhe flasin katër gjuhë të ndryshme: Gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe gjuhën retoromane. Çdo rajon gjuhësor ka veçoritë e tij kulturore. Në mënyrë që të ketë një bashkëjetesë që bazohet në respektin dhe konsideratën për tjetrin, ka ligje dhe rregulla specifike.

Në momentin e njohjes, njerëzit i drejtohen njëri-tjetrit zakonisht në formën e mirësjelljes – me «ju». Kur i drejtohen njëri-tjetrit me «ti», drejtohen me emër. Midis burrit dhe gruas ka barazi shoqërore.

Politika

Në Zvicër ka tre rrafshe politike: federata, 26 kantonet dhe mbi 2250 komuna. Rreth 5.3 milionë qytetarë, rreth 63% e të gjithë popullatës kanë të drejtën e votës në nivel federal. Kjo e drejtë i takon çdo banori me shtetësi zvicerane, i moshës 18 vjeç e lart. Demokracia zvicerane është ndërtuar sipas parimit të ndarjes së pushtetit.

Qeveria: Qeveria (Këshilli Federal) zvicerane është pushteti ekzekutiv. Ajo është një kolegji drejtues (d.m.th. Një grup prej shtatë anëtarësh të zgjedhur). Këta shtatë anëtarë zgjidhen nga parlamenti. Ata përfaqësojnë shtetin, merren me administrimin dhe zbatimin e ligjeve.

Parlamenti zviceran: Parlamenti zviceran (asambleja federale) përbëhet nga 246 deputetë. Ata zgjidhen nga populli. Zvicra është një demokraci e drejtpërdrejtë. Parlamenti zgjidhet çdo katër vjet nga populli zviceran. Ai përbëhet nga dy dhoma: Këshilli Kombëtar (200 anëtarë) dhe Këshilli i Shteteve (46 anëtarë). Ata kontrollojnë administratën dhe miratojnë ligjet.

Gjykata: Gjykata e Lartë zgjidhet nga asambleja federale. Ajo mbron ligjin, gjykon dhe dënon krimet.

Zvicra ka shumë parti politike. Në parlament ka njëmbëdhjetë parti. Ndër këto njëmbëdhjetë parti, nëntë prej tyre kanë edhe një parti rinore, e cila drejtohet nga të rinj që mbështesin të njëjtat ide politike. Në Këshillin Federal përfaqësohen partitë me përqindjen më të lartë të votuesve.

Në Zvicër, qytetarët dhe shoqatat kanë të drejtë të marrin pjesë në politikkbërje. Ata mund të ndërmarrin nisma ose të paraqesin peticione. Referendumet bëhen katër herë në vit.

Parlamenti (pushteti legjislativ):

www.parlament.ch

Strukturat politike, partitë vendore dhe strategjitë politike në Uster:

www.uster.ch/politik

Taksat

Kushdo që jeton në Zvicër duhet të paguajë taksa. Personat që kanë një vendbanim në Zvicër dhe nuk kanë një leje banimi (leje qëndrimi C), paguajnë tatim në burim. Punëdhënësit e tërheqin tatimin në burim direkt nga paga dhe e paguajnë atë pranë autoriteteve tatimore.

Në raste të caktuara, autoritetet tatimore kontrollojnë edhe pasurinë. Për shembull, nëse të huajt fitojnë më shumë se kufiri i caktuar. Në nivel federal dhe pothuajse në të gjitha kantonet, ky kufi është 120 000 franga. Kushdo që fiton më shumë se kaq, paguan taksa në bazë të një deklarate normale të të ardhurave. Informohuni paraprakisht se cilat taksa duhet të paguani dhe shmangni në këtë mënyrë pagesa të tepërta.

Personat e huaj me vendbanim në Zvicër dhe me një leje banimi (leje qëndrimi C) i deklarojnë të ardhurat dhe pasuritë e tyre përmes deklaratës normale tatimore, që plotësohet me një program kompjuterik ose përmes internetit (ZHprivateTax). Për t'ju ardhur në ndihmë, është në dispozicion një asistent për plotësimin e të dhënave. Programi kompjuterik mund të shkarkohet në faqen e internetit të zyrës tatimore të kantonit Zyrih.

www.zh.ch/steueramt

www.uster.ch/steueramt



BANIMI

Informacione të përgjithshme

Pasi të jeni transferuar në apartamentin e ri, prezantohuni me fqinjët. Fqinjët do ta vlerësonin një gjë të tillë. Rregullorja e banimit përcakton rregullat për qetësinë gjatë natës dhe përdorimin e mjediseve dhe hapësirave të përbashkëta (hyrja, shkalla, lavanderia etj.).

Uster është një qytet energjetik. Këtu i kushtohet rëndësi e madhe politikave mbështetëse për energjinë dhe klimën. Një qytet energjetik është një komunë apo qytet që angazhohet në përdorimin efikas të energjisë. Ai ka rregulla për mbrojtjen e klimës dhe kujdeset për një transport të padëmshëm për mjedisin. Është mirë që edhe vetë banorët e Usterit të veprojnë në mënyrë të padëmshme për mjedisin: Ata mund të bëjnë kujdes me konsumin e energjisë dhe të ujit, të kursejnë kostot e ngrohjes dhe t'i ndajnë plehrat.

www.uster.ch/themeenergiestadt

Informacionet rreth qiramarrjes së një banese në Zvicër i gjeni në fletën informuese "Banimi në Zvicër". Ajo është e disponueshme në 17 gjuhë.

www.bwo.admin.ch

Sigurimi i shtëpisë

Sigurimi i shtëpisë siguron sendet tuaja personale, p.sh. mobilet, pajisjet elektronike, rrobat, pajisjet sportive dhe pajisjet e kohës së lirë. Kur dikush i dëmton ose i vjedh këto sende, për këtë pagan sigurimi i shtëpisë. Sigurimet e shtëpisë sigurojnë dëmet nga zjarri, uji (uji i rubinetit dhe ujërat nëntokësore) dhe vjedhja. Keni gjithashtu mundësinë të siguronit rreziqe të tilla si për shembull vjedhje të zakonshme, humbje sendesh, tërmete ose dëmet e jashtme. Sigurimi i shtëpisë lidhet me një kompani sigurimesh.

Shërbimi i krahasimit të internetit, "Comparis", ju mundëson një krahasim pa pagesë të tarifave dhe shërbimeve. Aty jepen edhe krahasimet e çmimeve të kompanive të sigurimeve shëndetësore, kompanive të sigurimeve, kompanive të telekomunikacionit dhe shërbimeve shëndetësore.

www.comparis.ch

Tarifat

Për energjinë, ujin dhe kanalizimet do të merrni një faturë.

www.energieuster.ch

Në Zvicër çdo familje pagan tarifa shërbimi për radion dhe televizionin pranë agjencisë zvicerane të mbledhjes së taksave të radios dhe televizionit.

www.serafe.ch

Plehrat dhe riciklimi

Plehrat ndahen dhe hidhen në vendin e duhur. Pikat e shitjes marrin mbrapsht shishet PET, bateritë dhe shishet plastike. Nëpër komuna ka vendgrumbullime ku ju mund të hidhni shishe qelqi, kanaçe alumini dhe mbeturina të tjera. Letrat dhe kartonët vijnë i marrin pranë shtëpisë tuaj në data të caktuara. Për këtë shihni me kujdes kalendarin e hedhjes së plehrave. Pjesa tjetër e plehrave asgjësohet në thasë plehrash për të cilat paguhet një tarifë. Këta thasë plehrash i gjeni në supermarkete.

www.uster.ch/entsorgung



SHËNDETI DHE ÇËSHTJET SOCIALE

Sëmundjet dhe urgjencat

Urgjencat janë situata serioze dhe të rrezikshme për jetën. Plagosjet, helmimet, djegiet ose sëmundjet e papritura kërkojnë veprim të shpejtë. Mjekët duhet të trajtojnë çdo person në situatë urgjence ose ta drejtojnë atë në vendin e duhur. Kjo vlen edhe për personat që nuk kanë leje qëndrimi. Numrat e urgjencës i gjeni në faqen e fundit.

Si të sillësh në një situatë urgjence

Kontaktoni gjithmonë fillimisht me mjekun ose mjeken tuaj të familjes nëse keni një situatë urgjence, por jo të rrezikshme për jetën. Shërbime urgjente të ndihmës së shpejtë ka në të gjithë Zvicrën, edhe gjatë natës dhe fundjavave.

Nëse nuk arrini të lidheni dot me mjekun tuaj të familjes, sekretaria telefonike do t'ju thotë se cilin mjek të shërbimit të kontaktoni në rast urgjence. Në çdo rajon ka farmaci urgjence, edhe gjatë natës dhe fundjavave.

Numri i telefonit të mjekut për emergjencat e fëmijëve, të të rinjve dhe të të rriturve: **0800 33 66 55**

Ky numër telefoni është i disponueshëm 365 ditë në vit, 24 orë në ditë.

Gjatë një urgjence me rrezik për jetën, drejtojuni shërbimit të urgjencës së një spitali. Nëse është e mundur, telefononi fillimisht departamentin e urgjencës së spitalit. Në numrin e urgjencës shëndetësore **144** mund të lajmëroni edhe ambulancën. Normalisht, ambulanca transporton vetëm pacientë dhe jo persona shoqërues. Në disa raste duhet ta paguani vetë transportin me ambulancë (nga 850 deri 1900 franga). Prandaj është më e leverdisshme nëse ambulanca përdoret vetëm nëse gjendja e pacientit nuk lejon asnjë mënyrë tjetër transporti.

Sistemi mjekësor

Në Zvicër, mjekët e familjes janë përgjegjës për asistencën mjekësore bazë. Ata mundësojnë trajtime dhe këshillime mjekësore. Përveç kësaj, ata janë pika e parë e kontaktit për sëmundje dhe aksidente dhe mund t'ju rekomandojnë tek vendi i duhur (p.sh. tek mjeku specialist, spitali). Për këtë arsye, nëse jeni të sëmurë, shkoni gjithmonë tek i njëjti mjek familjeje, në mënyrë që ai ose ajo ta njohë historikun tuaj mjekësor dhe të mund t'ju trajtojë në mënyrën e duhur.

Siç keni ju një mjek familjeje, ashtu edhe fëmijët duhet të kenë një mjeke ose mjek pediatër. Ata kryejnë kontrollet e nevojshme dhe kujdesen për fëmijën kur ai është sëmurë. Krahas gjendjes shëndetësore, mjeku kontrollon rritjen dhe analizon zhvillimin fizik, mendor dhe shpirtëror të fëmijës.

Lista e mjekëve zviceranë:

www.doctorfmh.ch

Lista e mjekëve të familjes dhe e dentistëve në Uster:

www.medizin.ch/allgemeinmedizin-uster

www.medizin.ch/zahnmedizin-uster

Farmacitë

Farmacia është vendi i parë i rëndësishëm ku drejtoheni kur keni shqetësime shëndetësore. Farmacistët janë specialistë të mirëarsimuar për ilaçet dhe mund t'ju këshillojnë me kompetencë në rast sëmundjesh. Në varësi të gjendjes shëndetësore, ata do t'ju japin një ilaç ose do t'ju drejtojnë për tek mjekja ose mjeku juaj. Informacionet dhe këshillimi në farmaci parimisht është falas.

Në Zvicër, të gjitha ilaçet janë të disponueshme nëpër farmaci. Disa ilaçe, si për shembull qetësuesit e fortë të dhimbjeve ose antibiotikët, mund të merren vetëm me recetën e mjekut.

Në farmaci mund të merrni gjithashtu ilaçe bimore dhe suplemente.

Informacione të mëtejshme

Portali për shanset e barabarta shëndetësore: Informacione për shëndetin në 56 gjuhë, me specialistë dhe shoqërues. Informacione të mëtejshme lidhur me dentistët, vaksinimet, stresin mendor, shtatzëninë dhe shumë të tjera:

www.migesplus.ch

Qendra për parandalimin ndërkulturor të varësive dhe promovimin e shëndetit:

www.fisp-zh.ch

Sigurimi i shëndetit dhe ulja e primeve

Të gjithë personat që banojnë në Zvicër, duhet të sigurohen ndaj sëmundjeve dhe aksidenteve. Afati i regjistrimit është tre muaj pas lindjes ose transferimit në Zvicër. Jeni të lirë të zgjidhni një nga 53 kompanitë e sigurimeve shëndetësore.

www.krankenkassenversicherung.ch

Me shërbimin krahasues të internetit Priminfo të Zyrës Federale për Shëndetin Publik, ju mund të krahasoni pa pagesë tarifat e kompanive të sigurimeve shëndetësore.

priminfo.admin.ch

IPV – Reduktimi i primeve individuale

Personat me të ardhura të ulëta marrin një reduktim të primeve, që do të thotë se paguani më pak prime në kompanitë e sigurimeve shëndetësore.

Komunat kontrollojnë në bazë të faktorëve fiskalë se kush e ka të drejtën e reduktimit të primeve individuale dhe i raportojnë këta persona tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore të kantonit Zyrih (SVA). SVA u dërgon më pas këtyre klientëve formularin e kërkesës. Megjithatë, SVA-së mund t'i paraqitet kërkesa edhe drejtpërdrejt dhe më pas ai verifikon të drejtën për përfitim. Nëse paguani tatim në burim dhe e keni të drejtën, formulari i SVA-së së Zyrihut ju dërgohet automatikisht.

044 448 55 55 • info-ipv@svazurich.ch • www.svazurich.ch/ipv

Sigurimet

Sigurimi i përgjegjësisë private personale

Sigurimi i përgjegjësisë personale është i dobishëm për të gjithë personat. Nëse dëmtoni një person tjetër ose send, mund të lindin kosto të mëdha. Sigurimi i përgjegjësisë personale ju mbron nga këto kosto të larta. Ai kushton më pak dhe ofron siguri në raste dëmsh.

Shërbimi i krahasimit të internetit, "Comparis", ju mundëson një krahasim pa pagesë të tarifave dhe shërbimeve. Aty jepen edhe krahasimet e çmimeve të kompanive të sigurimeve shëndetësore, kompanive të sigurimeve, kompanive të telekomunikacionit dhe shërbimeve shëndetësore.

www.comparis.ch

Sigurimi ndaj aksidenteve

Si punëmarrës në Zvicër jeni të detyruar të siguroheni ndaj aksidenteve. Kjo vlen edhe për të rinjtë në zanat, praktikantët, punonjësit shtëpiakë dhe personelin sanitar në shtëpitë private.

Kujdes: Nëse punoni më pak se 8 orë në javë pranë një punëdhënësi, atëherë jeni të siguar vetëm ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Për aksidentet jashtë pune duhet të siguroheni vetë.

Edhe personat e vetëpunësuar dhe ata të papunë nuk janë të siguar automatikisht ndaj aksidenteve. Këtu përfshihen edhe personat shtëpiakë, fëmijët dhe studentët. Pra, as ky grup nuk është i siguar detyrimisht ndaj aksidenteve. Kjo do të thotë se ata duhet të lidhin një siguracion ndaj aksidenteve, për shembull pranë një kompanie sigurimesh shëndetësore.

Sigurimi shoqëror - Parimi i tre kolonave

Në Zvicër ekziston një rrjet i mbyllur sigurimesh shoqërore, që u ofron personave që jetojnë dhe punojnë këtu, si dhe familjeve të tyre, një mbrojtje ndaj rreziqeve që kanë pasoja financiare të pabërballueshme nga ata vetë. Dy kolonat e para ju sigurojnë për pensionin (AHV, pensioni i pleqërisë), për invaliditetin (IV, pensioni i invaliditetit) ose në rast vdekjeje të bashkëshortit ose të prindit (pension i trashëgimisë).

Nëse punoni, paguani kontribute deri në moshën 18-vjeçare, në rast papunësie deri në moshën 21-vjeçare. Nëse nuk jeni të punësuar dhe nuk merrni asistencë sociale, duhet të regjistroheshi vetë tek arka e kompensimit të kantonit tuaj.

www.ahv-iv.ch

Kontributet për AHV/IV/EO dhe ALV paguhen përgjysmë nga punëdhënësi dhe nga punëmarrësi. Ata që nuk janë të punësuar, duhet të paguajnë patjetër kontribute pranë AHV/IV/EO. Kontributi bazohet në masën e pasurisë dhe/ose të të ardhurave.

Kolona 1 (Detyrim)

AHV dhe IV përbëjnë së bashku kolonën e parë dhe të dytë shtetërore. Ajo vlen për të gjithë ata që banojnë dhe punojnë në Zvicër. Shërbimet e pensioneve të këtyre dy sigurimeve duhet të sigurojnë nevojën jetike. Kontributet tërhiqen direkt nga paga.

AHV: Pensioni i pleqërisë dhe i trashëgimisë (AHV) duhet të mbulojë nevojën jetike në rast mungese të ardhurash nga puna si pasojë e moshës së vjetër ose e vdekjes. Shërbimet varen nga masa e të ardhurave të deritanishme dhe nga kohëzgjatja e kontributeve.

IV: Përmes masave të integrit, sigurimi i invaliditetit u mundëson të siguarve invalidë të sigurojnë vetë, plotësisht ose pjesërisht, bazën jetike. Nëse një (ri)integrim i tillë nuk është i mundur ose është i mundur vetëm pjesërisht, IV paguan një pension (të pjesshëm). Integrimi ka përparësi ndaj një pagese pensioni.

Kolona 2 (Detyrim)

Kolona e 2-të është plan sigurimesh profesionale. Fondi i pensionit (PK) është i vlefshëm duke filluar nga të ardhura vjetore prej 20 520 frangash. Së bashku me kolonën e 1-rë ai duhet të mbulojë kostot e jetesës për të moshuarit, për trashëgimtarët në raste vdekjeje ose për invalidët. Ky fond siguron që këta njerëz të mund të ruajnë stilin e tyre të jetesës.

Kolona 3 (Vullnetarisht)

Kolona e tretë mund të ndahet në një plan sigurimesh që mund të mbahet nga të ardhurat e taksueshme dhe nga plani i sigurimeve vullnetare. Ajo lidhet me një shoqëri sigurimesh ose një bankë.

Sigurimi i papunësisë (ALV)

Në rast papunësie, pune me kohë të shkurtuar, ndërprerje të punës për shkak të motit ose kur punëdhënësi nuk mund të shlyejë pagën, atëherë paguan ALV-ja. ALV-ja paguan gjithashtu edhe për masat e riintegrit. Të gjithë punonjësit janë të detyruar të sigurohen me çdo kusht. Do të thotë që të gjithë paguajnë prime të ALV-së, që u mbahen nga paga e tyre. (Përfshijmë: Bujqërit dhe familjet e tyre, pensionistët) Punonjësit e vetëpunësuar nuk janë të siguruar. Ata duhet të lidhin një sigurim shtesë.

Shërbime plotësuese dhe kompensimi i të ardhurave (EO)

Shërbime plotësuese

Nëse pensioni juaj nga AHV/IV nuk është i mjaftueshëm për të jetuar, mund të aplikoni për shërbime shtesë. Shpjegimet duhet të bëhen mbi bazë individuale. Për këtë kontrollohet nevoja aktuale dhe përcaktohet masa e shërbimit.

Ndihmat financiare për familjet

Ato kompensojnë pjesërisht kostot për mbajtjen e një fëmije ose më shumë. Ndihmat financiare për familjet përfshijnë ndihmat financiare për fëmijët, ndihmat financiare për arsimin dhe ato për lindjet dhe birësimet. Për çdo fëmijë ekziston vetëm një e drejtë për një ndihmë financiare të të njëjtit lloj.

Kompensim për mëmësinë

Gratë e punësuar që bëhen me fëmijë marrin një kompensim për mëmësinë. Të gjithë ata që paguajnë AHV/IV, paguajnë një kontribut për kompensimin për mëmësinë. Kontributet paguhën së bashku me kontributet e AHV-së.

www.ahv-iv.ch



ARSIMI DHE PUNA

Çfarë duhet të dini për punën

Nga puna varen të ardhurat dhe mundësitë financiare për ju dhe ndoshta edhe familjen tuaj. Paga do të transferohet direkt në llogarinë tuaj bankare, të cilën mund ta hapni në një bankë ose postë.

Normalisht do të merrni një kontratë pune që rregullon kushtet e punës (orari i punës, paga, pushimet etj.). Disa industri kanë edhe kontrata kolektive e punës.

Nëse sëmureni, ju duhet normalisht një raport mjekësor duke filluar nga dita e 3-të. Aty mjeku konfirmon kohëzgjatjen e pamundësisë tuaj për të punuar. Kur largoheni nga një vend pune, keni të drejtën të kërkonit një vërtetim pune. Aty jepen informacione lidhur me llojin e punës dhe cilësinë e shërbimeve tuaja. Vërtetimet e punës janë të rëndësishme për kërkimin e një vendi tjetër pune.

Këshillimi profesional BIZ

BIZ Uster ofron informacione dhe këshillim për të gjitha pyetjet lidhur me arsimimin, profesionin dhe karrierën për të rinjtë dhe adoleshentët. Këshillimi është pa pagesë për personat nën 20 vjeç, për personat pa një diplomë shkolle (diplomë shkolle ose maturë) ose për personat që marrin ndihmë sociale ose bursë studimi. Informohuni pranë BIZ nëse mund të merrni një këshillim falas ose për kostot përkatëse. Përveç kësaj, ka edhe intervista të shkurtra 15 minutëshe për emigrantët, të cilat janë pa pagesë dhe nuk kërkojnë regjistrim.

Në infotekën e BIZ do të gjeni shumë materiale mediatike që ju informojnë rreth profesioneve të ndryshme. Në infotekë mund t'i studioni dokumentet aty, mund t'i huazoni ose disa prej tyre mund t'i merrni edhe falas.

BIZ ofron gjithashtu edhe seminare dhe takime të ndryshme. Për shembull, ka takime informuese për zgjedhjen e profesionit për prindër dhe adoleshentë të sferës së emigrantëve. Këto takime organizohen në gjuhë të ndryshme.

BIZ Uster, Brunnenstrasse 1, 8610 Uster
043 258 49 00 • www.ajb.zh.ch

RAV për papunësinë

Nëse jeni prekur nga papunësia ose ju kanë shkurtuar vendin e punës, është e rëndësishme që të kontaktoni menjëherë me RAV. Më pas do të këshilloheni gjatë periudhës së njoftimit paraprak për largimin nga puna dhe do të merrni mbështetje për gjetjen e një pune.

Si person në kërkim të punës, ju jeni të detyruar të bëni çdo përpjekje për t'i dhënë fund papunësisë. Këtu bën pjesë kërkimi i një vendi pune dhe bashkëpunimi me këshilluesin tuaj personal. RAV ju mbështet gjatë këtij procesi.

Edhe nëse nuk merrni kompensim për papunësinë, përsëri mund të kërkoni këshillim nga RAV.

RAV Uster, Brunnenstrasse 1, 8610 Uster
043 258 43 43 • hotline.ravuster@vd.zh.ch • www.awa.zh.ch

Njohja e diplomës

Ju mund të bëni njehsimin e diplomave të huaja. Ky njehsim bëhet nga Sekretariati Shtetëror për Arsimin, Kërkimin shkencor dhe Novacionin (SBFI): Ai është pika juaj e parë e kontaktit për çështje të përgjithshme që lidhen me njohjen e diplomave dhe certifikatave të huaja. Aty mund të informoheni rreth njohjes së kualifikimit tuaj profesional. Dokumentet tuaja mund t'i verifikoni tek SBFI përmes portalit online.

SBFI Njohja e diplomave të huaja
058 462 28 26 • kontaktstelle@sbfi.admin.ch • www.sbf.admin.ch



LËVIZJA

Transporti publik

Në Uster shkohet lehtësisht me tren: Janë katër linja të S-Bahn që e lidhin qytetin rregullisht dhe lehtësisht me rrethinat. Për të lëvizur drejt ose jashtë Zyrihut mund të përdorni linjat e S-Bahn S5, S9, S14 dhe S15.

Gjatë netëve nga e premtja në të shtunë dhe nga e shtuna në të diel, si dhe para shumicës së ditëve të festave, funksionon linja hekurudhore SN5. Çmimet dhe oraret e udhëtimeve i gjeni në faqen e internetit të rrjetit zviceran të transportit (ZVV).

Një rrjet i ngjeshur autobusësh përfshin periferinë e Usterit dhe komunat përreth.

Biletat dhe abonetë mund të blihen në çdo automat ose sportel të stacionit ose përmes aplikacionit. E rëndësishme: Biletat duhet të blihen dhe stampohen para udhëtimit. Biletat ditore ose me një përdorim mund të stampohen në disa autobusë, por jo në qytetet e mëdha. Fëmijët deri në 6 vjeç udhëtojnë pa pagesë, fëmijët e moshës nga 6 deri në 16 vjeç udhëtojnë me çmim të reduktuar dhe falas me kartën Junior të shoqëruar nga një i rritur. Nëse jeni duke lëvizur me biçikletë, blini një Velobillett.

Transporti hekurudhor Federal Zviceran - www.sbb.ch

Aplikacioni: SBB mobile në App Store ose Play Store të celularit tuaj

Zürcher Verkehrsverbund ZVV - 0848 988 988 - www.zvv.ch

Aplikacioni: Biletat e ZVV në App Store ose Play Store të celularit tuaj

Transporti rrugor

Zhdoganimi

Për mjetet motorike që janë përdorur jashtë vendit për të paktën 6 muaj, nuk duhet paguar doganë kur importohen në Zvicër. Ato i përkasin kategorisë që quhen mallrat e shpërnguljes. Plotësoni formularin e aplikimit (18.44 Übersiedlungsgut) në zyrën doganore dhe paraqitni lejen e qarkullimit të automjetit dhe dokumentet tuaja të qëndrimit.

Patenta e shoferit

Nëse keni një patentë të huaj, duhet ta shndërroni atë brenda një viti me një patentë vendase. Për në Zvicër ju nevojitet një patentë zvicerane. Paraqitni kërkesën pranë zyrës së qarkullimit rrugor ose pranë zyrës së regjistrimit të banorëve. Për këtë ju nevojitet patentja juaj e huaj dhe leja e qëndrimit. Informohuni gjithashtu nëse ju nevojitet një udhëtim provë. Të gjithë qytetarët e BE-së përjashtohen nga detyrimi i këtij udhëtimi provë.

Targat e makinës

Edhe targa e makinës duhet të ndërrohet brenda një viti. Regjistrohuni pranë zyrës së qarkullimit rrugor për një kontroll të automjetit tuaj. Përveç kësaj, ju nevojitet leja origjinale e qarkullimit të automjetit tuaj dhe vërtetimi i sigurimit zviceran të automjetit. Merrni gjithashtu me vete edhe policën tuaj të sigurimit. Udhëzim: Në Zvicër, të gjithë personat që zotërojnë një automjet duhet të kenë një sigurim për përgjegjësinë personale.

Shpejtësia dhe rregullat e qarkullimit

Shpejtësia e vlefshme përgjithësisht në autostradë është 120 km/h, në rrugët e makinave është 100 km/h, në rrugët jashtë zonave të banuara është 80 km/h, brenda zonave të banuara është 50 km/h dhe brenda lagjeve është 30 km/h. Tek të gjitha rrugët qarkullimi bëhet në anën e djathtë (që do të thotë automjetet lëvizin në korsinë e djathtë), dhe në rrethrotullime automjeti me motor ka përparësi në rrotullim.

Pulla e autostradës (taksa e autostradës)


Në autostradë ju nevojitet një pullë autostrade. Ajo kushton 40 franga në vit dhe mund të blihet për shembull në sportelin e postës ose pranë një stacioni karburanti. Ajo duhet të ngjitet mbi xhamin e përparmë jo më vonë se data 31 janar e vitit të ri.

Zyra e qarkullimit rrugor Hinwil, Studbachstrasse 8, 8340 Hinwil
058 811 40 00 • info@stva.zh.ch • www.stva.zh.ch

Lëvizja me makina me qira (lëvizja e përbashkët)

Si klientë të "Mobility" mund të rezervoni një automjet në çdo orë të ditës dhe mund ta hapni me kartën tuaj Mobility ose me SwissPass. Automjetet janë të disponueshme në nëntë kategori.

www.mobility.ch



PIKAT E KONTAKTIT DHE SHËRBIMET NË ZONËN E USTERIT

Qëllimi i integritimit është përfshirja e të gjithë banorëve në sferën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Kjo nënkupton shanse të barabarta për të gjithë personat që jetojnë në Zvicër. Fokusi është njohja me vendbanimin e ri, me vlerat dhe zakonet. Personat e sapoardhur duhet të krijojnë kontakte dhe shoqëri në vendbanimin e tyre të ri.

Qyteti Uster - Pika qendrore e kontaktit për informacionet e para

Qyteti i Usterit i ndihmon të gjithë ata që janë transferuar në Uster së fundmi. Ekipi ynë ju këshillon me kënaqësi lidhur me çështje kulturore, familjare dhe administrative. Në dispozicionin tuaj janë gjithashtu edhe specialistë të tjerë të sferës së familjes dhe të mbështetjes.

Për integrimin optimal të fëmijëve dhe adoleshentëve mund t'i drejtoheni zyrës për çështjet që lidhen me fëmijët, adoleshentët dhe gjithëpërfshirjen. Jeni gjithashtu të ftuar përземërsisht në një intervistë personale. Ato mundësohen në gjuhë të ndryshme. Nëse jeni të interesuar mund të kontaktoni qendrën e specializuar.


Qyteti Uster, Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen
Bahnhofstrasse 17, 8610 Uster

Mësimi i gjermanishtes

abc Deutschkurse

Ky kurs gjermanishteje rekomandohet dhe mbështetet nga qyteti i Usterit. Gjermanishtja për fillestarët dhe për të përparuarit mësohet pranë qendrës familjare në Uster. Krahas mëimit të gjermanishtes, ky kurs ofron edhe asistencë për fëmijët. Aty do të mësoni të flisni, të kuptoni dhe të shkruani gjermanishten standarde si dhe do të zbuloni më shumë për jetën në Zvicër.

Elisabeth Karth-Zehnder, Steinstrasse 3, 8610 Uster
044 940 05 62 • elisabeth.karth@bluewin.ch
www.abc-deutschkurse.ch



Kurse gjermanishteje nga kisha e reformuar e Usterit

Kursi i gjermanishtes është për të gjithë ata që duan të mësojnë ose të thellojnë njohuritë e gjuhës gjermane, por që kanë mundësi financiare të ulëta. Nivelet e ofruara në kurs janë A1 deri B2. Kursi zhvillohet çdo të mërkurë dhe të enjte nga ora 09:00 deri në orën 11:00 (me përjashtim të pushimeve shkollore të qytetit të Usterit) në godinën e kishës Kreuz, me asistencën e integruar të fëmijëve deri në 5 vjeç.

Kisha e reformuar e Usterit, Rémy Beusch
Zentralstrasse 40, 8610 Uster
044 943 15 11 • remy.beusch@refuster.ch
www.refuster.ch/deutschkurse

Institucione dhe shërbime të tjera

Bildungszentrum Uster

Höhere Berufsbildung Uster, Berufsschulstrasse 1, 8610 Uster
044 943 64 22 ▪ info@hbu.ch ▪ www.hbu.ch

Akrotea.ch GmbH

Joweid Zentrum 1, 8630 Rüti ZH
055 462 38 28 ▪ info@akrotea.ch ▪ www.akrotea.ch

WBK Dübendorf

Bettlistrasse 22, 8600 Dübendorf
044 801 84 84 ▪ info@wbk.ch ▪ www.wbk.ch

Klubschule Migros Wetzikon

Bahnhofstrasse 151, 8620 Wetzikon
058 712 44 70 ▪ www.klubschule.ch/Standorte/Zuerich/Wetzikon

DuoLingo

Mësim gjuhe pa pagesë në një platformë gjuhe online ose si aplikacion.
www.duolingo.ch

Biblioteka e qytetit Uster

Në bibliotekën e qytetit Uster do të gjeni një gamë të gjerë mjetesh mediatike (libra, filma, lojëra, gazeta), vende pune të qeta, një sallë leximi me kafe, kompjutera dhe internet WLAN. Aty zhvillohen rregullisht organizime.

Biblioteka e qytetit dhe e rajonit Uster, Bankstrasse 17, 8610 Uster

044 944 77 50 ▪ info@stadtbibliothek-uster.ch
www.stadtbibliothek-uster.ch



Qendra për familjet në Uster

Nënat, baballarët dhe fëmijët takohen me njëri-tjetrin në Qendrën për familjet në Uster. Ata ndjekin së bashku programet dhe takime të ndryshme. Qendra për familjet është një pikë takimi e preferuar për prindërit. Ajo ofron këshillime dhe kurse. Specialistë të jashtëm ofrojnë gjithashtu shërbime në qendrën për familjet.

Femmes Tische

“Femmes Tische” janë grupe diskutimi midis grave (ose edhe burrave) të moderuara në gjuhë të ndryshme. Në grupe të vogla diskutohet për çështje të familjes, të shëndetit dhe të integritetit. Synimi i tyre është përforcimi i burimeve personale dhe rrjetit shoqëror.

Qendra për parandalimin e varësive, Nicole Stadler

Gerichtsstrasse 4, 8610 Uster

043 399 10 84 • n.stadler@femmestische-zo.ch

www.femmestische.ch

Shërbimet e shkrimit

Persona vullnetarë ju ndihmojnë gjatë leximit dhe shkrimit. Ata ju shpjegojnë rreth letrave dhe dokumenteve në gjuhën gjermane. Ata ju ndihmojnë të plotësoni formularë dhe kërkesa. Ata Kërkojnë pikat e duhura të kontaktit për nevojat që ju keni (p. sh. për çështje që lidhen me sigurimet shoqërore, me kërkimin e një banese, me kontratat e punës, me kontratat e qirasë, heqjen nga puna etj.). Shërbimi i shkrimit është pa pagesë dhe është në dispozicion të të gjithëve.

Çdo të mërkurë nga ora 10:00 deri në 12:00 dhe nga ora 13:00 deri në 19:00. Nuk është nevoja të regjistroheni.

Qendra për familjet, Zentralstrasse 32, 8620 Uster

www.familienzentrum-uster.ch





KOHA E LIRË

Klubet

Klubet janë një element thelbësor i jetës sportive, kulturore dhe shoqërore në qytetin Uster. Mundësitë që ofron qyteti Uster për kohën e lirë janë të shumta dhe ka diçka tërheqëse për këdo.

www.uster.ch/vereinsliste

Në Uster ka shoqata emigrantësh, të cilat mund t'ju mbështesin në jetën e përditshme. Doni të shkëmbeni më shumë informacione? Doni të informoheni për diçka konkrete? Doni të krijoni kontakte? Shoqatat ju mbështetin për një hyrje dhe integrim sa më të mirë në shoqërinë zvicerane.

Qendra për çështje të integrimit e kantonit Zyrih
Neumühlequai 10, 8090 Zürich • 043 259 25 37
info@migrantenvereine.ch • www.migrantenvereine.ch

Puna vullnetare


Puna vullnetare është një dhuratë për shoqërinë tonë. Persona vullnetarë ndihmojnë në shumë fusha të jetës. Në qytetin Uster ka shumë vullnetarë aktivë të moshave të ndryshme. Ata ndihmojnë në sfera të tilla si shëndetësia, jeta sociale, azili, kultura, sporti dhe politika.

www.uster.ch/freiwilligenarbeit

Eventet në qytetin Uster

Në qytetin Uster bëhen shumë organizime: koncerte, organizime sportive, ekspozita, filma kinematografikë, teatër, konferenca, seanca leximi e të tjera.

www.uster-agenda.ch
www.uster.ch/anlaesseaktuelles



PIKAT E KONTAKTIT

Migraweb

Migraweb është një shërbim online nga emigrantët për emigrantët. Migabweb ofron informacione dhe këshillime online rreth jetesës në Zvicër. **www.migraweb.ch**

ch.ch

Edhe ky shërbim online ofron gjithashtu informacione rreth jetesës në Zvicër. Ky është një shërbim i ofruar nga qeveria federale, kantonet dhe komunat rreth temave të tilla si: sigurimet, ndihmat financiare për familjet, patentat, integrimi etj. **www.ch.ch**

Sekretariati shtetëror për emigrimin (SEM)

SEM është një autoritet federal. Ai është përgjegjës për çështje që lidhen me të huajt në përgjithësi dhe me njohjen e refugjatëve të huaj (njohja dhe revokimi i azilit) në Zvicër. **www.sem.admin.ch**

Qendra e integritit e kantonit Zyrh

Kjo qendër organizon dhe koordinon në nivel kantonal integrimin e njerëzve. Ajo kujdeset për personat që janë transferuar në Uster së fundmi. Ajo mbështet gjithashtu edhe qytetet dhe komunat në integrimin e të sapoardhurve. Kjo qendër organizon edhe programe integrimi. **www.integration.zh.ch**

Zyra e emigracionit e kantonit Zyrh

E drejta e qëndrimit në kantonin Zyrh dhe në Zvicër rregullohet përmes të drejtës federale. Zyra e emigracionit e zbaton këtë të drejtë. Pas analizimit të kërkesave përkatëse, ajo lëshon leje hyrjeje dhe leje qëndrimi. Zyra e emigracionit është përgjegjëse për zgjatjen e vizave dhe për lëshimin e vizave të kthimit.

Berninastrasse 45, 8090 Zürich

043 259 88 00 • info@ma.zh.ch • www.ma.zh.ch

Qyteti Uster

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Bahnhofstrasse 17

8610 Uster

044 944 72 06

079 876 72 92 (WhatsApp)

Email

integration@uster.ch



NUMRAT DHE ADRESAT E URGJENCËS

Listën me numrat e ndryshëm të urgjencës e gjeni në faqen e internetit:

www.uster.ch/telefonnummern

Urgjenca të përgjithshme (centrali telefonik i policisë)	112
Zjarrfikësi	118
Policia	117
Urgjenca shëndetësore (ambulanca)	144
Policia e qytetit Uster	044 944 76 66
Helmimet: Qendra zvicerane e informacionit rreth toksikologjisë	145
Shërbimi i urgjencës mjekësore (24 orë/ditë – 365 ditë/vit)	0800 33 66 55
Shërbimi i urgjencës farmaceutike (e premte ora 18.00 – e hënë ora 06.00)	0900 553 555 (1.50/Min.)
Ndihma mjekësore spitalore	044 911 23 23
Spitali i Usterit	044 911 11 11
Shërbimi i urgjencës së dentistit në Zyrh Oberland	079 358 53 66
Shërbimi i urgjencës psikiatrike	044 931 39 39
Ndihmë për të rinjtë Ndihmë telefonike për fëmijët dhe adoleshentët	147
Streha e grave dhe qendra e këshillimit në Zyrh Oberland Mbrotjtje dhe siguri, si dhe këshillim dhe shoqërim i bazuar në burime dhe i personalizuar sipas qëllimit përkatës.	044 994 40 94 info@frauenhaus-zuercher-oberland.ch

Qyteti Uster

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Bahnhofstrasse 17

8610 Uster

044 944 72 06

079 876 72 92 (WhatsApp)

Email

integration@uster.ch